19261

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT TIRANË

Nr. 19261 Vendimit.

## V E N D I M

## PËR REGJISTRIMIN PERSON JURIDIK TE SHOQERISË TREGETARE PRODHUESE KONFEKSIONE " SYMBOL " SH.P.K.

Në Tiranë, sot më datën 16 04.1998, Unë gjyqtari [signature] i gjykatës së rrethit të Tiranës, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesit 1) Saimir Bidaj biri i Sadikut dhe Shyqyries lindur më 1965 dhe banues ne Tiranë, rruga "Hoxhë Vokrri" P.37, Apart.9 2) Ismail Dani biri i Hasanit dhe i Hatixhes, lindur më 1959 dhe banues ne Krujë, rruga "Lekë Zaharia" Nr.32, për regjistrimin person juridik te shoqerisë tregetare prodhuese konfeksione "Symbol" Sh.P.K. dhe,

## K O N S T A T O V A  S E :

Kërkuesit kanë paraqitur kërkesen e tyre në këtë gjykatë, për regjistrimin person juridik të shoqerisë tregetare prodhuese konfeksione me emrin "Simbol", SH.P.K. Import-Export, me qender ne Tiranë, rruga "Siri Kodra" në teritorin e Frigoriferit te Math, me objet veprimtarie : prodhimin dhe tregetimin e konfeksioneve te ndryshme, artikujve industriale e ushqimore, te transpotimit te mallrave te ndryshme brenda e jashte vendit, import-eksportit me shumicë e pakicë . Me nji kohëzgjatje mbi 10 vjet në mënyrë të vazhdueshme dhe pa kufizim, me nji kapital fillestar prej 100.000 ( njiqindmijë) lekë. Dhe me administratorë të dy ortakët Saimir Bidaj dhe Ismail Dani.

Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura nga kërkuesit, rezulton se kërkese e tyre ësntë e drejtë dhe e bazuar në ligj, e si e tillë duhet pranuar.

## P Ë R  K Ë T Ë  A R S Y E

Dhe në bazë të ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Për Shoqeritë Tregetare"

## V E N D O S A

Regjistrimin e shoqerisë tregetare prodhuese konfeksione "Symbol" Sh.p.k. person juridik, me qender ne Tiranë, rruga "Siri Kodra" ne teritorin e Frigorifet te math, me objekt prodhimin e tregetimin e konfeksioneve, tregetimin e artikujve industriale e ushqimore, te transportimit-mallrave te ndryshme etj te import-exportit me shumicë e pakicë, me kohëzgjatje mbi 10 vjet, me kapital fillestar 100.000 lekë, dhe me administratore Saimir Bidaj dhe Ismail Dani.

Kundra këtij vendimi lejohet ankim në gjykaten e shkallës dyte, Apel.

G J Y Q T A R I

( [signature] )

[signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 05 05.2003, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Saimir Bidaj, i cili kerkon te depozitoje vendimin e Asamblese se Ortakeve per ndryshimin e selise se shoqerise "SYMBOL" SHPK;

KONSTATOVA

Me vendimin nr.19261, date 16.04.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria SYMBOL SHPK , me ortak e administrator Saimir Bidaj dhe Ismail Dani,me seli ne Tirane,rruga "Siri Kodra", Brenda frigoriferit te madh.

Me vendimin nr.1, date 02.05.2003 te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur ndryshimi i selise se shoqerise nga rruga "**"Siri Kodra", Brenda frigoriferit te madh**, ne rrugen "5 Maji", perballe NISH Kimikes.

Ai kerkon te behen keto ndryshime ne skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit Tregtar prane Gjykates suaj.

Kerkesa e tij per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri per ndryshim emertimi edhe ne Skeden Perkatese te kesaj shoqerie , eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

VENDOSA;

Pranimin e kerkeses.

Depozimin e Vendimit nr. 1, date 02.05.2003 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SYMBOL" SHPK per ndryshimin e selise se shoqerise.

Duke u bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen e 2,germa "b", me numer rendor 2 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**
**TIRANË**
**Nr. ____________ Vendimi**

## VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 21/ 12/ 2004, unë Ariana Caco gjyqtare pranë kësaj gjykate pasi studiova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga z.Saimir Bidaj në cilësinë e Ortakut dhe Administratorit të shoqërisë "SYMBOL" sh.p.k, për depozitimin ne Rregjistrin Tregtar, prene Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, te vendimit nr.1, date 01.12.2004, te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve të shoqërisë "SYMBOL" sh.p.k

### KONSTATOVA SE:

Shoqeria " SYMBOL " sh.p.k, me seli ne Tirane, eshte krijuar me vendim Nr. 19261 date 16.04.1998, te gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Ne mbledhjen e Ortakeve të shoqerise,"SYMBOL" sh.p.k, date 01.12.2004, nga ana e ortakeve jane mare ne diskutim problemet e rendit te dites lidhur me largimin e ortakut Ismail Dani prej shoqerise dhe zevendesimin nga Znj. Shqipe Dani.

Me vendimin Nr.1 date 14.09.2004, asambleja e jashtezakonshme e ortakeve te shoqërisë "SYMBOL" sh.p.k ka vendosur :

- Te pranoje largimin e ortakut Ismail Dani nga shoqeria dhe zevendesimin si ortake nga Shqipe Dani .
- Ndryshimin e nenit 6 te statutit te shoqerise si me poshte vijon :

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte derdhut teresisht nga ortaket Saimir Bidaj dhe Shqipe Dani te cilet zoterojne 50% seicili.

- Ndryshimin e adreses se shoqerise ne Rr. » 5 Maj » , Tirane.

Vendimi i mesiperm eshte marre me unanimitet te plote te ortakeve te shoqerise

### PËR KËTO ARESYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar " dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

### VENDOSA:

Pranimin e kerkeses .

Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr.1 date 01.12.2004, te asamblese se ortakevete shoqerise " SYMBOL " sh.p.k dhe te kontrates se shitjes Nr.6641 Rep. dhe Nr. 526 Kol. date 01.12.2004.

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne Regjistrin Tregtar. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

**GJYQTARE**

Ariana Caco

# Modeli regjistrimi

-19261-

- Emërtimi "Symbol" sh.p.k.

- Kapitali 100.000 lekë

- Kohëzgjatja nuk ka afat

- Me objekt import eksport, prodhim shitje të konfeksioneve etj.

- Me ortak Selim Biolaj dhe Ismail Sheu me administrator të dy ortakët

- Me seli në Fier, me territor e Republikës së Shqipërisë.

Paguhet: 6 fletë
Akt themelimi 2 fletë
Data e noterizimit 16.04.08
Data e regjistrimit 16.04.08

Sekretari

# A K T - T H E M E L I M I

## I

## SHOQËRISË PRODHUESE - TREGËTARE KONFEKSIONE" SYMBOL" SH.P.K.

Në bazë të ligjit Nr.7638 date 19.11.1992"Për shoqerite tregetare" si dhe te ligjit Nr.7667 dt.26.1.1993 ,Ne Ortakët : 1) Saimir Bidaj biri i Sadikut dhe Shyqyries,lindur me 10.12.1969 dhe banues ne Tiranë,Rruga "Hoxhë Vokrri",P.37,Apart.9. 2) Ismail Dani biri i Hasanit dhe Hatixhes,lindur në 22.4.1959 dhe banues ne Krujë "Rruga Lekë Zaharia"Nr.2,ne aty me zotesi juridike për të vepruar deklarojmë se vijon :

### Neni 1

Në Tiranë,sot më daten 14.4.1995 themelojmë shoqerinë private me përgjegjesi te kufizuar me emrin " Shoqeria prodhuese-tregetare konfeksione "Symbol" Sh.P.K.Import export, e cila ka ortaket 1)Saimir Bidaj dhe 2)Ismail Dani .

### Neni 2

Qendra e kësaj shoqerie është në Tiranë,rruga "Siri Kodra" brenda teritorit te frigoriferit te math. Kjo shoqeri ka te drejte te hapi dege filjale dhe agjensi te te gjithe teritorin e Shqipërisë si dhe jashte Republikes se Shqipërisë me miratimin e organeve kopetente si dhe në përputhje me legjislacionin e vendeve ku do te hapen këto agjensi .

### Neni 3

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike te kësaj shoqerie është e pa kufizuar në mënyrë të vazhdueshme dhe mbi 10 vjet. Ajo mundet te shpërbehet në çdo kohë dhe për çdo shkak sipas vendimeve që do të marrin Ortakët e kesaj shoqerie permendur më sipër .

### Neni 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË TË KËSAJ SHOQERIE

Objekti i veprimtarisë të kesaj shoqerie do te jete : Prodhimi dhe tregëtimi i konfeksioneve,artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, të transportimit te mallrave te ndryshme,Import-Export me shumice dhe me pakicë.

### Neni 5

### KAPITALI FILLESTAR I SHOQËRISË

Kapitali fillestar i shoqerisë është 100.000(njëqindmijë ) lekë dhe e vendosur si vijon :

1)Saimir Bidaj 50 %

2)Ismail Dani 50 %

Kapitali i kësaj shoqerie mund te shtohet ose te pakësohet sipas vendimeve që dote marrin Ortakët në Asamblenë e Ortakëve .

Neni 6

Shoqëria private Prodhuese tregetare konfeksione "Symbol" SH.P.K. Import Export, vepron në regjimin e pronës private dhe veprimtaria e saj do te rregullohet në bazë te normave që përmban statuti i saj si dhe te rregullores së brendeshme te shoqerisë .

Neni 7

Administratorët e kesaj shoqerie do te jenë te dy Ortakët qe themelojnë shoqerinë tregetare "Symbol" Sh.P.K; z. Saimir Bidaj dhe Ismail Duni .

Neni 8

Ndryshimet në këtë Akt - themelimi do te bohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me te cilën u bë Akti i Themelimit dhe te krijimit te shoqerisë tregetare .

Neni 9

Ky Akt-Themelimi u redaktua ne kater kopje, prandaj dhe nënëshkruhet regullisht prej neve ortakeve themeluesa përpara noterit ne Tiranë .

ORTAKËT THEMELUESA TE SHOQERISË PRODH. TRG. KONFEKSIONE "SYMBOL" SH.P.K.

( Saimir Bidaj )   ( Ismail Duni )

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERIVE TIRANE
Nr. 1588 rep. Nr. 159 kol.

V E R T E T I M

Sot më dt. 16.4.1998 para meje noterit ne Tiranë, u paraqiten personalisht Z. Saimir Bidaj dhe Ismail Duni, për identitetin e tyre u sigurova me leter njoftimet e tyre me Nr. respektive [illegible] dhe [illegible], me zotesi juridike për te vepruar, te cilat deklarojnë sa më sipër, për aktin e themelimit te kësaj shoqerie dhe nënëshkruan ate regullisht, prandaj unë noteri bëra vertetimin e këtin Akti Themelimi .

N O T E R I

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

# S T A T U T I

I

## SHOQERISE PRODHUESE-TREGTARE KONFEKSIONE "SYMBOL" SH.P.K.

Në mbështetje te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Për shoqerite tregetare" si dhe te ligjit 7667 date 28.1.1993 "Për rregjistrimin ne regjistrin tregetar" te quajturit Saimir Bidaj dhe Ismail Dani ,me zotësi juridike për te vepruar shpallin si vijon :

### Neni 1

### FORMIMI I SHOQERISE PRODHUESE TREGTARE

Formohet shoqeria prodhuese tregetare Konfeksione me emrin " SYMBOL " SH.P.K., me Ortakët e në poshtëm :

1) Saimir Bidaj,biri i Sadikut dhe i Shygyries,lindur ne 10.12.1965 dhe banues ne Tiranë,rruga "Hoxhë Vokrri" P.57,Apart.9 .

2) Ismail Dani ,biri i Hasanit dhe Hetixhes,lindur me 22.4.1959 dhe banues në Kruje,rruga "Lokë Zeharia" Nr.32 .

### Neni 2

### QENDRA E SHOQERISË PRODHUESE TREGTARE KONFEKSIONE "SYMBOL"

Qendra e shoqerisë "Symbol" Konfeksione SH.P.K. është në Tiranë rruga "Siri Kodra" brenda teritorit të frigoriferit Fatn . Shoqeria mund te hapi dhe vendqendrime te tjera ,te dyta dhe filjale ne te gjithë teritorin e vendit dhe jeshte saj me miratimin e organeve përkatese kopetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do te hapen keto agjenci .

### Neni 3

### KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohezgjatja e veprimtarisë ekonomike është e pa kufizuar dhe mbi 10 vjet.Ajo mundet te shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo shkak ose mundet te zgjatet kjo kohë me vendimin e Asamblesë së Ortakëve .

### Neni 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë te kësaj shoqerie do të jete :Prodhimi dhe tregetimi i konfeksioneve,artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore,të transportimit te mallrave te ndryshme,Import-Exportit,me shumicë dhe pakicë

### Neni 5

Shoqeria tregëtare mund te ndryshojë emërtimin e saj,vendqendrimin,si dhe veprimtarinë me vendimin e ortakëve e Asamblese .

## Neni 6

## KAPITALI FILLESTAR I SHOQERISË

Kapitali fillestar i shoqerisë është 100.000(Njiqindmijë ) lekë dhe i vendosur në masën :

1) Saimir Bidaj 50 %.
2) Ismail Deni 50 %.

Detyrimet e antarit kundrejt shoqerisë janë vetem për pjesen e kapitali të derdhur nga ai .Për detyrimet e tjera te shoqerise,antari nuk mban p përgjegjesi.Kapitali i kësaj shoqerie mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve që do të marrin ortakët në Asamblenë e Ortakëve .

## Neni 7

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI SHOQERISE

Shoqeria prodhuese tregetare konfeksione "Symbol" deklarohet e krijuar në zbatim te plotë te normave që permban ky statut si dhe legjislacioni -nit shqiptar në fuqi .Ajo konsiderohet e krijuar në daten e regjistrimit ne regjistrin tregetar ne gjykaten e rrethit te Tiranes dhe pasi të meret licensa përkatose nga organi përkates i tatimeve .

## Neni 8

Ortakët e shoqerisë me krijimin e kësaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin .Ajo mund te behet vetem pas nxierjes së bilancit te shoqerisë për pjesen e fitimit te realizuar.

## Neni 9

Abas rregjistrimit te shoqerisë ne gjykaten e rrethit te Tiranes të drejtat e antareve dhe pjeset e tyre shoqerore qe u takojnë atyre nga pasuria e shoqerisë përcaktohen nga çdo antar.Pjeset e tyre shoqerore perputhen me pjeset e kapitalit te sejcilit antar.

Çdo antar mund te kete nji pjese shoqerore.Neqoftë se antari siguron pje-së të tjera shoqerore,atehere pjesa e tij rritet në perputhje me këtë .

Pjeset e tija antari i shoqerise mund tju ofrojë të tretëve neqoftëse ai ka derdhur pjesen e kapitalit themelor. Antaret e shoqerisë kane përparësi për blerjen e pjeses shoqerore përpara te tretëve .

Pas blerjes se pjeses shoqerore personi i tretë mund te fitojë te drejtet e antarit te shoqerisë neqoftese ai ka njohur me parë te drejtat dhe detyrimet e shoqerisë .

Blerësi i pjeses shoqerore nuk kërkon modifikimin e kontrates.Derdja e kapitalit tek Administratori i shoqerisë ose ne llogarinë rjedhese behet sipas kushteve të vëna nga ortakët .

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht te transferueshme dhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshorteve si dhe ndermjet paraardhëesve dhe pasardhesve.

Përparesi kanë antaret e shoqerisë dhe në qoftëse Asamblea e Ortakëve nu-k jep pëlqimin brenda tre muajëve ,atehere u ofrohen këto kapitale të tretëve .

Neni 10

Emërtimi i shoqerisë,kapitali themeltar si dhe emrat e ortakëve duhet te jenë të permëndura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te tretëve.Shoqeria ka vlerën e saj ma madhësi të zakonshme dhe te përhapjen për rreth.

Neni 11

Shoqeria private vepron ne rregjimin e pronës private dhe merr përsipër vete te drejta e detyrime kontraktore dhe jashtekontraktore.Pronaret e shoqe-risë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit te shoqerisë si dhe p për detyrimet që ka shoqeria ndaj të tretëve pa kufizim .

Neni 12

Administratoret e shoqerisë janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejt-e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerisë pa asnji kufizim . Ata kanë mundesi që te kryejnë te gjitha aktet që i konsiderojnë te ligjëshme për arritjen e qellimeve te shoqerisë ,kanë te drejta qe te blejnë e këmbajnë pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja,duke siguruar pjesmarrje për arritjen e qellimeve te shoqerisë .

Neni 13

A S A M B L E A

Organi me i lartë i shoqerisë është Asamblea, që vendos për çdo çështje, që nuk është ne kundershtim me ligjin . Asamblea duhet te mblidhet te paktën 1 herë në vit. Asamblenë e mbleth administratori ose ata antare te shoqerisë q që perfaqesojnë 1/10 e kapitalit te shoqerisë. Antaret duhet te njoftohen te paktën 15 dite përpara mbledhjes se Asamblese .

Nëqofte se Asamblea nuk është mbledhur sipas rregullave ajo ka te drejtë te marrë vendim vetem atehere kur çdo antar është prezent dhe qe nuk kundershtojnë thirrjen e Asamblesë .Çdo antar ka te drejtë te vere në rendin e ditës problemin që ai dëshiron .Për kete duhet te njoftohen antaret 5 ditë para .Nëqofte se për çështje te ndryshme antaret nuk janë njoftuar, atehere ato mund te shqyrtohen vetem kur janë prezent te gjithë antaret e shoqerisë dhe nuk kundershtojnë thirrjen e Asamblesë .

Antaret e asamblesë mund te vendosin dhe pa berë mbledhjen e Asamblesë.

Projekt vendimet e propozuara jashte asamblesë brenda 8 diteve duhet tu behen të njohura antareve të tjerë .Këta antarë duhet të japin votën e tyre me telefax.Po kështu për rezultatin e votimit administratori njofton antaret 3 ditë pas përfundimit të votimit .

## Neni 14

## TË DREJTAT E ASAMBLESË

- Miratimi i bilacit te shoqerise dhe ndarja e fitimit .
- Përjashtimi i antarit .
- Zgjedhje e administratorit dhe shkarkimi tij e drejta e administratorit për të punësuar .
- Aprovimi i kontratave vlera e te cilave nuk kalon te paktën 1/4 e kapitalit themeltar ose te kontratave ndermjet administratorit dhe antare-ve .
- Vendimi për ndrprerjen e aktivitetit ,riorganizimi,bashkimi me nji shoqeri tjeter si dhe krijimi i shoqerive te tjera ekonomike .
- Modifikimi i kontrates së shoqerisë .Asamblea vendos për çdo gjë me shumicë votash .

## Neni 15

## E DREJTA E VOTIMIT

Duke u bazuar ne kapitalin fillestar antaret e shoqerisë kanë këtë te drejtë votimi .

1) Saimir Bidaj 50 % vota .
2) Ismail Dani 50 % vota .

## Neni 16

Nuk mund te votojë si antar i shoqerisë që është i interesuar për çështjen që po diskutohet .Në rast se votimet janë te barabarta do të vendoset me short .

## Neni 17

## A D M I N I S T R A T O R I

Zgjidhjen e problemeve te shoqerisë e bejnë administratoret, të cilët përfaqesojnë asamblenë në nji kohë te caktuar.Për zgjedhjen e shkarkimin e tyre është e domozdoshme 61 % e votave te antareve te asamblenë.

Administratorët e shoqerise Saimir Bidaj dhe Ismail Dani përfaqesojnë shoqerinë para të tretëve,para gjykates dhe organeve kopetente . te drejtat e tyre ne çështje te ndryshme dhe zgjidhjen e tyre,administratori mund tua besojë antareve te shoqerisë. E drejta e punësimit u takon administratoreve

## Nëni 18

Për modifikimin e kontratës është e domozdoshme 3/4 e Asamblesë . Detyrimet e reja të anëtarëve të shoqerisë mbi detyrimet që përcakton kontrata si dhe mënimi i të drejtave të anëtarit duhet të vendoset vetëm unanim .

Neni 19

MARRËDHËNJET E PUNËS .

Marrëdhënjet e punës së shoqerisë rregullohen nëpërmjet kontratës së punës përveç dispozitave të parashikuara në kontratësn e punës dhe të parashikuara në legjislacionin përkatës .

Neni 20

Shoqeria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësim-mit e të sigurimeve shoqërore për të gjithë të punësuarit në të,ndërsa këta të fundit janë të detyruar që të pranojnë këtë statut .

Neni 21

Të punësuarit në këtë shoqeri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas këtij statuti për moszbatimin e këtyre detyrave të ngarkuara dhe dëmet që ata i shkaktojnë kësaj shoqerie me veprimet ose mosveprimet e tyre .

Neni 22

SEKRETI I PUNËS

Konsiderohen si sekret pune të kësaj shoqerie të gjitha aktet dhe dokumentet që janë vendosur si të tilla nga administratorët e kësaj shoqerie .

Neni 23

KONTROLLI I BRENDSHËM

Shoqeria organizon kontrollin e brendshmem me ekspertë kontabël të autorizuar ose të emëruar me afat ose pa afat prej administratorëve të shoqërisë .

Neni 24

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Veprimtaria ekonomike e shoqerisë do të zhvillet më datën 31 Dhjetor,përveç rasteve të veçanta të administratorëve të shoqerisë.Në fund të çdo periudhe ata nxierrin bilancin kontabël me rezultatin ekonomik FITIM-HUMBJE inventar si dhe përgatisin raportin përkatës me shkrim .

Neni 25

Me miratimin e bilancit vjetor shoqeria vendos dhe përcakton zhvillimin e fondeve të veçanta për zhvillimin e shoqerisë .Pas veçimit të fondeve si më sipër dhe pagimit të detyrimeve fiskale, të ardhurat neto që mbesin mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse .

## NENI 26

Në rast se kapitali i shoqerisë rezulton për shkak të humjeve të realizuèara më pak se gjysma e kapitalit themeltar bashkëpronaret vendosin brenda 4 muajve nga data e mbarimit te llogarisë mbi mundesinë e prishjes së parakoheshme të shoqerisë . Nese prishja nuk shmanget shoqeria zvoglon kapitalin e saj në vlere me të vogel se ajo e humbjes që kanë mbetur pa mbuluar nga fondet rezervë .

## Neni 27

## SHPËRNDARJA OSE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Shoqeria private ndryshon organizimin e saj në formën e shoqerimit si dhe pushon veprimtarinë në formën e likuidimit.Për këtë qëllim shoqeria tregetare krijon komisionin e likuidimit i cili paraqet bilancin e likuidimit. Mbasi mbyllet shoqeria ajo kryen të gjitha dokumentat e nevojeshme dhe veprimet e duhura për çregjistrimin e saj nga rregjistri tregetar .

## Neni 28

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përsa nuk është shprehur ne kete statut i referohet legjislacionit shqiptar dhe regullores se brendeshme të nxjerrë nga Administratorët. Ndryshimet e plotesimet e këtij statuti behen në të njëjtën mënyrë siç nxiret vete ky statut. Ndryshimet e bera ne kete statut nuk prekin personalitetin juridik te kësaj shoqerie private .

## Neni 29

Ky statut u redaktua ne kater kopje,e pasi nënshkruhet rregullisht nga administratoret e saj para noterit dhe merr formë ligjore pas miratimit tij dhe te kësaj shoqerie nga organet përkatese,Gjykates se rrethit Tiranë dhe Zyres së tatimeve Tiranë .

ADMINISTRATORËT :

( Seimir Bidaj )     ( Ismail Dani )

PULLE TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE    Nr. 1588 rep.
ZYRA E NOTERES TIRANË    Nr. 159 vol.

VERTETIM

Sot më dt.16 Prill 1998 para meje noterit u paraqiten personalisht : Seimir Bidaj dhe Ismail Dani,për identitetin e tyre u sigurova me leternjoftimet e tyre me Nr. respektiva[illegible] dhe [illegible],me zotesi juridike për te vepruar,të cilët deklaruan se më sipër është statuti i shoqerisë"Symbol" dhe unë e vërtetova rregullisht këtë statut.

NOTERI

Gjyltere Pustina

REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA "SYMBOL" SHPK

VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

NR.1, DATE 02.05.2003

Me vendimin nr.19261, date 16.04.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria SYMBOL SHPK , me ortak e administrator Saimir Bidaj dhe Ismail Dani,me seli ne Tirane,rruga "Siri Kodra", Brenda frigoriferit te madh.

Sot, me date 02.05.2003

**V E N D O S E M :**

Ndryshimin e selise se shoqerise nga rruga "**"Siri Kodra", Brenda frigoriferit te madh**, ne rrugen "5 Maji", perballe NISH Kimikes.Ndryshimi i selise se shoqerise nga rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", pall.27, ap.5 Tirane, ne rrugen e "Myslym Shyri", nr.117/1.

Kerkoj te behen keto ndryshime ne skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit Tregtar prane Gjykates suaj.

ORTAKET

SAIMIR BIDAJ ISMAIL DANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 1415 Rep.

V E R T E T I M

Vertetojme se sot, me date 05.05.2003, para meje noteres u paraqit kerkuesi Saimir Bidaj dhe Ismail Dani per identitetin e te cilve pasi u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper u be me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
AFRDITI GJ... ERO

Shoqeria "SYMBOL" sh.p.k
Me seli ne Tirane, Rr."S.Kodra".

## VENDIM NR.1

## I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Sot me date 01.12.2004 ne ortaket e Shoqerise "SYMBOL" sh.p.k me seli ne Tirane, Rr."S.Kodra", e miratuar si person juridik me vendim te Gjykates Shkales Pare, Tirane Nr. 19261, date 16.04.1998, nga ortaket Saimir Bidaj dhe Ismail Dani, me zoterim seicili te 50% te kuotave te kapitakit.

Sot me daten 01.12.2004, ne mbledhjen e ortakeve

**V E N D O S E M :**

1.Miratimin e dhurimit te kuotave te kapitalit ne masen 50% nga ana e z. Ismail Dani, per znj.Shqipe Dani.
Shoqeria "SYMBOL" shpk ketej e tutje do te jete me ortake, me zoterim te kuotave te kapitalit ne mase te barabarte nga Saimir Bidaj 50% dhe Shqipe Dani 50%.

2.Miratiohet si administratore e shoqerise "SYMBOL" sh.p.k, edhe znj. Shqipe Dani, qe se bashku me z.Sajmir Bidaj do te administrojne kete shoqeri.

3.Meqense shoqeria "SYMBOL" shpk ka kauar me seli, ne adrese te re vendosem ndryshimin e adreses se Shoqerise ne Rr."5 Maji",Tirane.

ORTAKET

Saimir Bidaj          Ismail Dani

"SYMBOL" shpk Tiranë ALBANIA Rr. Sin Kodra Frigoriferi i mëparshëm

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 6664 Rep. Nr. 526 Kol.

N. e Taks
U
Pagua

**KONTRATE DHURIM**

Pjese te Kapitali Themeltar te Shoqerise"SYMBOL"sh.p.k
/Bazuar ne nenin 761 e vijim te Kodit Civil/

Ne Tirane me 01.12.2004 (dymije e klater) para meje noter Arian A.Merkuri, me studjo ne Tirane, Rr."Reshit Çollaku", P.Shallvaret, shk.1, ap.2 u paraqiten palet :

**DHURUESIT**: **Ismail Dani**, i biri i Hasanit dhe i Haixhes, shtetas shqiptar, lindur ne Kruje me22.04.1959 dhe banues ne Kruje, mbajtes i leternjoftimit NF Nr:286630 ne cilesine e Ortakut dhe administratorit te Shoqeria "SYMBOL" sh.p.k

**PRANUES DHURIMI**:**Shqipe Dani**, e bija e Maliqit, lindur ne Kruje me 17.07.1961, banuese ne Kruje, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtese e pasaportes me Nr:Z0334440,leshuar me 29.11.2002.

**HYRJE**

Z.Ismail Dani, eshte ortak dhe administrator ne Shoqerise"SYMBOL"sh.p.k, me seli ne Tirane,Rr."S.Kodra", e regjistruar si person juridik ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin nr.19261, date 16.04.1998, ne te cilen zoteron 50%(pesedhjetperqind) te kapitali ne kete shoqeri,pjesa tjeter prej 50%(pesedhjetperqind),zoterohet nga Ortaku dhe Administratori, Saimir Bidaj.

Neni 1

Dhuruesi Ismail Dani, deklaron me vullnetin e tije te plote se i dhurojne z.Shqipe Dani, pjesen e tij te kuotave prej 50%(pesedhjetperqind), qe ai zoteron ne Shoqerine "SYMBOL" sh.p.k

Neni 2

Znj. Shqipe Dani, deklaron se e pranon dhurimin e bere nga Z. Ismail Dani, ne sasine e mesiperme, pra ne shumen 50%(pesedhjetperqind)te kuotave, si dhe te gjitha detyrimet qe rrjedhin prej prej tij.

Neni 3

Dhuruesi Ismail Dani, garantone pranuesen e dhurimit Shqipe Dani, se kuotat qe dhurohen jane te lira nga çdo barre, peng apo hipoteke dhe menjehere te disponueshme.

Neni 4

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhuruesve Ismail Dani humb te drejten e pronesise se kapitalit ne shoqerine "SYMBOL" sh.p.k, si dhe te drejten e administrimit te saj si administrator, te drejta keto qe kalojne ne favor te pranueses se dhurimit znj.Shqipe Dani.

Neni 5

Pranuesja e ketyre kuotave znj. Shqipe Dani, behet ortake dhe administratore ne Shoqerise "SYMBOL" sh.p.k, me zoterim te 50%(pesedhjete) perqind te kapitalit dhe do te gezoje edhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe burojne nga pronesia mbi keto kuota.

Kontrata shtypet me mjete elektronike ne kater kopje te njejta e te barabarta dhe pasi lexohet nenshkruhet nga palet me vullnet te plote e te lire.

Une, noteri, duke qene i bindur per identitetin dhe vullnetin e tyre te plote e te lire ne perpilimin dhe firmosjen e kesaj kontrate, e vertetoj sipas ligjit

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT

Shqipe Dani

NOTERI

ARIAN MERKURI

## KERKESE

(Per depozitimin e vendimit nr.1 te dt. 01.12.2004 te Shoqerise "SYMBOL " sh.p.k)

**Kerkuesi :** Saimir Bidaj, Administratori i shoqerise SYMBOL Sh.p.k. me adrese: Rr."S.Kodra",Tirane.

**Objekti :** Regjistrim i vendimit nr. 1 te dt. 01. 12. 2004, shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SYMBOL" Sh.p.k dhe depozitimi i dokumenteve ne regjistrin tregetar

**Baza ligjore :** Ligji Nr.7683 ,date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe Ligji Nr.7667 date 28.01.1993" Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar per shoqerite tregetare". Aktet themelore dhe statuti i shoqerise .

GJYKATES SE SHKALLES PARE
TIRANE

Shoqeria "SYMBOL" Sh.p.k eshte regjistruar si person juridik me Vendim nr. 19261, date 16.04.1998. me ortak z.Saimir Bidaj dhe z.Ismail Dani, me zoterim 50 % te kuotave seicili.

Me kontraten e dhurimit Nr.6641 Rep. Nr.526 Kol. dt.01.12.2004, pjesa e kapitalit te zoteruar nga Z.Ismail Dani ne shoqerine "SYMBOL" sh.p.k. i eshte dhuruar z.Shqipe Dani.

1. Ne perputhje me kontraten e dhurimit, kapitali i shoqerise SYMBOL sh.p.k , do te kene kete zoterim te kuotave nga Saimir Bidaj 50% dhe Shqipe Dani 50%
2. Administratore e shoqerise "SYMBOL" shpk, ketej e tutje te jete perveç z.Sajmir Bidaj edhe znj.Shqipe Dani.
3. Ndryshimin e adreses se shoqerise "SYMBOL" sh.p.k ne adresen Rr."5 Maji", ne Tirane.

Vendimi i mare nga Asambleja e Ortakeve , eshte ne baze te Nenit 59, 60 e 62 te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite Tregetare" dhe neneve 13 e 14 te Statutit te shoqerise.

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare" dhe te ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare", i kerkojme Gjykates suaj te depozitoje ndryshimet e kapitalit te ortakeve te shoqerine "SYMBOL " sh.p.k dhe depozitimin ne aneksin e regjistrit tregetar te dokumenteve perkatese bashkelidhur kesaj kerkesa

KERKUES
SAIMIR BIDAJ

1926/1
05.05.2003

B Mucaj 08.05.2003

PULLE TAKSE 50 LEKE R. SHQIPERISE
PULLE TAKSE 50 LEKE R. SHQIPERISE

# K E R K E S E

**KERKUESI** : Saimir Bidaj, i biri i Sadikut dhe i shyqyries, dtl. 1965, banues ne Tirane, rruga "Hoxhe Vokrri", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e administratorit te shoqerise;

**OBJEKTI** ; Depozitim i vendimit te Asamblese se ORTAKEVE te shoqerise SYMBOL SHPK date 02.05.2003 per ndryshimin e selise se Shoqerise

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Me vendimin nr.19261, date 16.04.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria SYMBOL SHPK , me ortak e administrator Saimir Bidaj dhe Ismail Dani,me seli ne Tirane,rruga "Siri Kodra", Brenda frigoriferit te madh.

Me vendimin nr.1, date 02.05.2003 te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur ndryshimi i selise se shoqerise nga rruga ""**Siri Kodra", Brenda frigoriferit te madh**, ne rrugen "5 Maji", perballe NISH Kimikes.

Kerkojme te behen keto ndryshime ne skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit Tregtar prane Gjykates suaj.

KERKUESI

Saimir Bidaj

Vendimi Nr 1 dt. 02.05.03 i Asamblese per Ortakeve

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 1415 Rep.

V E R T E T I M

Vertetojme se sot, me date 05 05.2003 , para meje noteres u paraqit kerkuesi Saimir Bidaj per identitetin e te cilit pasi u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper u be me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTER
AFERDITA GJERGJO

MOD. 7 BANKA KOMBETARE TREGTARE

MANDATARKETIMI
(I BRENDHSEM)

MANDAT ARKE 2

Nr. 053395

| | | Kundravlefta në Lekë |
|---|---|---|
| MONEDHA | | I00.000 |
| KOMISIONE BANKARE | | 500 |
| ARKETUAR GJITHSEJ | | I00.500 |

SHUMA ME FJALE ( NJEQINDMIJEPESEQIND. )

ME URDHER ISMAIL DANI SAIMIR BIDAJ

NE KREDI SH P K "SYMBOL" NE KRIJIM

NUMRI I LLOGARISË 4705/II4/02

PER DERDHJE KAPITALI FILLESTAR

VENDI TIRANE DATA I4 PRILL 1998

URDHERUESI (EMRI MBIEMRI)

| DISTINA | | |
|---|---|---|
| COPE | PRERJE | SHUMA |

SHUMA

METALIKE

GJITHSEJ

VULA DHE NENSHKRIMET E BANKES

ARKETARI

SPORTELISTI

PERGJEGJESI SPORTELIT

Çeqet titujt me vlerë dhe dokumentet e ngjashme për kreditim në llogari jane të pranueshme nga Banka e .................... me rezerve per verifikim. Kur ato kthehen pa paguar Banka debiton me iniciative llogarinë e përfituesit. Në rast mungese të gjendjes ne llogari, perfituesi detyrohet ti kthejë menjëherë Bankës shumën përkatëse kundrejt kërkesës së thjeshtë të saj.

DHOMA E AVOKATEVE TIRANE

AVOKAT
Hysen Broçe
TIRANE

Z. A. Copo 26.4.1998

Tiranë, më 16.4.19

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

# K Ë R K E S Ë

K Ë R K U E S A : 1) Saimir Bidaj biri i Sadikut dhe i Shyqyries, 10.12.1965 dhe banues në Tiranë, rruga "Hoxhë V Apart.9 . 2) Ismail Dani biri i Hasanit dhe Ha dur më 22.4.1959 dhe banues në Krujë, rruga " L Nr.32.

O B J E K T I : Rregjistrimin si person juridik, te shoqerisë pr tregetare konfeksione "Symbol"Sh.p.k. . Baza li gji Nr.7638 dt.19.11.1992"Për shoqeritë tregeta

GJYKATËS SË RRETHIT
T I R A N Ë

Ne te dy kerkuesit kemi vendosur te ushtrojmë veprimtari priv krijuar shoqërinë tregetare prodhuese konfeksionesh, te artikujve dhe ushqimore, te transportimit te mallrave te ndryshme brenda dhe vendit, import -Export, me shumicë dhe me pakicë . Që të dy kërkues jemi administratore. Qendra e shoqerisë qe krijojmë do te jete br rit te frigoriferit te math, në rrugen "Siri Kodra ". Pra, te dy kë jemi ortakë dhe administratorë. Kapitali fillestar i shoqerisë do te jete 100.000 ( njiqindmijë lekë), nga 50% te kapitalit vënë nga sejcili Ortak.

Kohëzgjatja e veprimtarisë është e pa kufizuar mbi 10 vjet dhe me aktivitet te vazhdueshem . Mirë por më parë duhet qe shoqeria jonë duhet te regjistrohet si person juridik pranë regjistrit tregetar te gjykates se rrethit te Tiranës konforme ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 dhe ligjit Nt.7667 dt.28.1. 1993 .

P r a n d a j,

lutemi qe te shqyrtohet kërkesa jonë dhe te vendoset rregjistrimi si person juridik te shoqerisë tregetare prodhuese konfeksione "Symbol"SH.P.K., me objekt prodhimin dhe tregetimin e konfeksioneve te ndryshme, te artikujve industriale dhe ushqimore dhe transportimin e mallrave te ndryshme brenda dhe jashte vendit, me shumice dhe me pakicë, me kohëzgjatje e pa kufizuar mbi 10 vjet, me kapital fillestar 100.000 lekë, me qender ne teritorin e frigoriferit te math ne rrugen "Siri Kodra" dhe me administratore te dy ortakët Saimir Bidaj dhe Ismail Dani .

K Ë R K U E S I T :

( Saimir Bidaj ) ( Ismail Dani )